

Menaxhimi i Aseteve

Shërbime Këshillimore për Shoqëritë Ujës-jellës Kanalizime

Programi

Ky Program ofron ndihmë teknike, program kompjuterik dhe zhvillim të kapaciteteve për një grup të përzgjedhur prej rreth 110 Shoqëri UK nga Ballkani Perëndimor (Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi dhe Serbi) për të kryer një gamë të plotë aktivitetesh në fushën e Menaxhimit të Aseteve në sShoqëritë UK.

Programi ka filluar në vitin 2017 për Shoqëritë UK në Bosnje-Hercegovinë, Serbi, Maqedoni dhe Mal të Zi dhe që nga janari 2019 do të jetë i hapur edhe për Shoqëritë UK nga Shqipëria dhe Kosova.

Shërbimet

Stafi i secilës Shoqëri UK pjesëmarrëse merr shërbimet që përfshijnë:

1. **Seminare / konferenca** : Do të mbahen rregullisht për të paraqitur aspekte të ndryshme të shërbimeve dhe MIA.
2. **Konvertimin e të dhënave & zbatimin e sistemeve MIA**: Programi EDAMS IAM, që do të ofrohet për çdo shoqëri UK, do të ruhet dhe përdoret në Cloud.
3. **Trajnim në klasë** : Kurset e trajnimit do të mbahen në mjediset e HUB në mënyrë të rregullt duke trajtuar të gjitha aspektet e MIA përmes fazave të ndryshme të programit.
4. **Vizitat** : Shoqëritë inkurajohen të vizitojnë HUB në intervale të rregullta për të kërkuar këshilla dhe ndihmë.
5. **Mbështetje**: Mbështetje ditore në distancë për Shoqëritë UK gjatë përdorimit të softuerit dhe për procedurat e miratuara.
6. **Akses në shërbime shtesë MIA** : Nëse kërkohet, do të ofrohet me një kosto shtesë për të ndihmuar Shoqërinë me studime si hartimi i një Plani Tregtar Rehabilitimi, Plani Investimi, Plani Rehabilitimi & Mirëmbajtjeje dhe Plane Infrastruktura.



Kush mund të marrë pjesë?




Shoqëritë Ujës-jellës Kanalizime në Shqipëri dhe Kosovë janë të mirëpritura të aplikojnë në këtë program. Aplikimet do të renditen sipas mundësive të shoqërisë për thithje kapitali, sipas potencialit teknik dhe gatishmërisë për të marrë pjesë në program.

Qasja

Zbatimi i praktikave të Menaxhimit të Integruar të Aseteve në Shoqëritë UK do të arrihet përmes përdorimit të një pakete risi që përfshin formimin e Hub-eve kombëtare të Menaxhimit të Aseteve dhe përdorimin e sistemeve informative për menaxhimin e integruar të asetëve EDAMS (tashmë të përshtatur për rajonin e Ballkanit Perëndimor). Hub-i për Menaxhimin e Aseteve do të sigurojë ngritjen e kapaciteteve për Shoqëritë UK pjesëmarrëse për të kryer aktivitetet e MIA-s përmes trajnimeve, mbështetjes dhe ofrimit të softuerëve dhe metodologjive sipas praktikave më të mira. Në rastet kur Shoqëritë UK u mungojnë burimet e njerëzore për të zbatuar plotësisht aktivitetet e MIA, Hub-i për MA do të ofrojë shërbime shtesë për t'i ndihmuar këto shoqëri që të kryejnë këto aktivitete.

Hub-et e MA ofrojnë një program me 3 faza. Supozohet se çdo Shoqëri UK do të jetë në gjendje të përparojë nga një fazë në tjetrën pas përfundimit të fazës paraardhëse. Përvoja e deritanishme ka treguar se përafërsisht 2/3 e shoqërive pjesëmarrëse arriten të kalojnë nga njëra fazë në tjetrën brenda një periudhe një vjeçare.

- **Faza 1:** Qëllimi i Fazës 1 do të jetë të ndihmojë shoqëritë UK të ngrënë dhe mirëmbajnë një bazë të dhënash rrjeti gjeografik, duke kryer në mënyrë efektive **Menaxhimin e të Dhënave të Rrjetit** si dhe të kuptojnë përbërësit e Menaxhimit të Integruar të Aseteve (MIA).
- **Faza 2:** Qëllimi i Fazës 2 do të jetë të mundësojë **Menaxhimin e Mirëmbajtjes** për të përmirësuar produktivitetin dhe efikasitetin e funksionit të mirëmbajtjes dhe dhënies së shërbimit, si dhe për regjistrimin e problemeve të mirëmbajtjes për përdorim të mëtejshëm në Planifikimin e Rehabilitimit / Mirëmbajtjes (Faza 3)
- **Faza 3:** Faza e vitit të fundit do të mundësojë aktivitetet e mbetura të Menaxhimit të Integruar të Aseteve. Bazuar në vlerësimin e nevojave dhe interesit të shprehur, gjatë 2 viteve të para të programit, do të vendoset se cilat dy temat (nga pesë në dispozicion) do të zbatohen. Pesë temat janë: (a) **Menaxhimi i të dhënave tregtare**, (b) **Menaxhimi i cilësisë së ujit**, (c) **Menaxhimi i shpërndarjes / ujit pa të ardhura (NRW)**, (ç) **Planifikimi i mirëmbajtjes / rehabilitimi** dhe (d) **Planifikimi i Infrastruktursë**.



Partneriteti

Shërbimet do të ofrohen në partneritet midis Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH - GIZ, **Hydro-Comp Enterprises Ltd.** Qipro, Shoqata Ndërkombëtare e Ndërmarrjeve të Ujësjellësit në pellgun e lumit të lumit Danub (**IAWD**), dhe Hub-i kombëtar i MA për Shqipërinë (**SHUKALB**) dhe për Kosovën (**SHUKOS**).

Kostot e pjesëmarrjes

Shoqëritë e suksesshme do të paguajnë tarifën e anëtarësimit prej 50 € në muaj për Hub-in e MA. Të gjitha shpenzimet, që lidhen me transportin dhe akomodimin për seminarët dhe trajnimet do të mbulohen nga programi.

Shoqëritë UK do të paguajnë një **pagesë vjetore** vetëm për përdorimin e softuerit. Nivelet e tarifave varen nga madhësia e Shoqërisë dhe popullata të cilës i shërben. Për shembull, për ato Shoqëri UK me madhësi mesatare që i shërbejnë një popullatë prej 40 000 deri në 150 000 banorë, tarifa shkon nga 200 € deri në 400 € në muaj, në varësi të madhësisë dhe fazës së programit. Shtatë kompanitë rajonale të ujësjellësit në Kosovë do të marrin ofertë individuale.

Për pyetje shtesë dhe regjistrim:

Për informacione shtesë lutemi kontaktoni Hub-in për Menaxhimin e Aseteve (MA):

- SHUKALB at info@shukalb.al tel. +35542245101 (për Shoqëritë UK në Shqipëri)
- SHUKOS në shukos2001@gmail.com tel. +38338526873 (për Kompanitë Rajonale në Kosovë)

